

V E N D I M
Nr.236, datë 10.5.1993

**PËR ADMINISTRIMIN E FURNIZIMIT ME UJË PËR PËRDORUESIT FAMILJARË
DHE JOFAMILJARË**

datë 10.5.1993, "Për administrimin e furnizimit me ujë për përdoruesit familjarë dhe jofamiljarë"

I perditësuar me:

- ***VKM nr. 96, datë 21.2.2007***

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Furnizimi me ujë të pijshëm e teknologjik nga ndërmarrja e ujësjellësit për konsumatorët privatë e shtetërorë bëhet në bazë të kontratave të shitjes që lidhen ndërmjet palëve.
2. Konsumatorët jofamiljarë shtetërorë ose privatë që furnizohen me ujë nga këto ndërmarrje, të sigurojnë dhe të vendosin me shpenzimet e tyre matësit e ujit deri në datën 31.7.1993. Ndërmarrjet e ujësjellësit përcaktojnë kapacitetin, tipin dhe projektin e vendosjes së tyre. Me kalimin e këtij afati ndërmarrjet e ujësjellësit të ndërpresin furnizimin me ujë të tyre. Pasi konsumatori vendos matësin sipas projektit të miratuar nga ndërmarrja e ujësjellësit, mbahet një procesverbal i përbashkët.
3. Konsumatorët jofamiljarë, shtetërorë ose privatë, që furnizohen me ujë të pijshëm, i sigurojnë, administrojnë dhe ruajnë vetë matësit e ujit. Në rast dëmtimi konsumatori jofamiljar duhet të njoftojë, me shkrim, ndërmarrjen e ujësjellësit dhe të marrë masa për ta zëvendësuar matësin e ujit, brenda 30 ditëve. Pagesa e konsumit të ujit për këtë periudhë bëhet në bazë të normave të konsumit mesatar mujor të konsumatorit. Nëse ndërmarrja e ujësjellësit nuk njoftohet për dëmtimin e matësit ose matësi nuk vendoset brenda afatit të caktuar, konsumatori (jofamiljar) detyrohet të paguajë konsumin mesatar të ujit me 5-fishin e çmimit.
4. Në rast se konsumatori nuk paguan detyrimin, që ka ndaj ndërmarrjes së ujësjellësit, në bazë të kontratës për furnizimin me ujë, detyrohet të paguajë një shtesë për kamatëvonesë 0.5 për qind të vlerës së konsumit të ujit për çdo ditë vonese, por jo më shumë se 10 për qind. Nëse pagesa nuk kryhet brenda 30 ditësh, ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë. Shpenzimet e kryera nga ndërmarrja e ujësjellësit, për rilidhjen e konsumatorit me rrjetin e furnizimit me ujë, të përballohen nga konsumatori.
5. Ndërhyrjet në sistemin e ujësjellësit, lidhjet e pamiratuara nga ndërmarrja e ujësjellësit dhe dëmtimet e çdo lloji dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë deri në 10 mijë lekë për konsumatorët familjarë dhe deri në 50 mijë lekë për konsumatorët jofamiljarë, si dhe me ndërprerje të furnizimit me ujë. Vendimet e dënimit jepen nga inspektori i kontrollit të ujit dhe nga punonjësi i autorizuar nga drejtori i ndërmarrjes së ujësjellësit. Kundërvajtësit detyrohen të paguajnë edhe shpenzimet e nevojshme për sjelljen e pjesës së dëmtuar në gjendjen e mëparshme.

6. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij, te drejtori i ndërmarrjes së ujësjellësit, akti i të cilit është i formës së prerë.

7. Për rastet e parashikuara në pikat 2, 4 dhe 5 të këtij vendimi, kur ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë, kontrata ndërmjet palëve konsiderohet e zgjidhur.

Me kërkesën e konsumatorit ndërmarrja e ujësjellësit bën rilidhjen e furnizimit me ujë brenda 30 ditëve, pasi konsumatori të ketë paguar detyrimet ndaj ndërmarrjes së ujësjellësit dhe të gjitha shpenzimet për ndërprerjen e rilidhjen e furnizimit me ujë. Pasi të jetë bërë rilidhja, konsumatori lidh kontratë të re me ndërmarrjet e ujësjellësit.

8. Ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, organet e pushtetit lokal dhe ndërmarrjet e ujësjellësit për hartimin e programit për plotësimin me matës uji të konsumatorëve familjarë.

9. Të gjitha aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi